

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6119  
E hënë, 21 shtator 2020  
çmimi 0.40 €

## Në ditët e ardhshme do të jetë gati Spitali për Covid-19



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### DORËZIMI I DOSJEVE TË GJYKATËS SPECIALE NË ORGANIZATËN E OVLUÇK-së KA NXITUR REAGIME TË SHUMTA

# HARADINAJ: PUBLIKIMI I DOSJEVE TË SPECIALES NUK I NDIHMON KOSOVËS



Publikimi i dosjeve të Gjykatës Speciale është kritikuar nga vendorët dhe ndërkombëtarët. Zyrtarët vendorë dhe ndërkombëtarë kanë vlerësuar se kjo nuk është në favor të drejtësisë. Ndërkaq ish-kryeministri i Kosovës, lideri i

AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë të dielën se kjo situatë po krijon padrejtësisht përshtypjen se Kosova është rreshtuar në anën e kundërt të drejtësisë. Ai ka porositur që kushdo që has në dokumente sensitive të hetuesisë e të gjykatave

menjëherë duhet t'ua dorëzojë institucioneve përgjegjëse. "Zhvillimet e fundit rreth kësaj teme, që po ushqejnë debatin mediatik, nuk i ndihmojnë Kosovës, të vërtetës së saj, dhe drejtësisë vendore e ndërkombëtare", ka thënë Haradinaj

## OPINION

### A ËSHTË E MUNDUR TË JETË BASHA KRYEMINISTRI I ARDHSHËM I SHOQPËRISË? ÇFARË THONË SONDAZHET (JO ATO PUBLIKE)

Nga Bedri ISLAMI



## AKTUALE

### RAMA THOTË SE ÇËSHTJA E DETIT ME GREQINË DUHET TË SHKOJË DREJT GJYKATËS NDËRKOMBËTARE

### SHKOLLA E MESME "ANTON ÇETTA" NË SKENDERAJ BËHET ME SALLË TË EDUKATËS FIZIKE

## EKONOMI



### GASTRONOMËT TË PAKËNAQUR, THYEJNË PJATA PARA QEVERISË

### VETËVENDOSJA THOTË SE SERBIA FORCOHET ME MARRËVESHJET INFRASTRUKTURE

## SPORT

### FERONIEKLI DEKLASOI GJILANIN, FITOJNË EDHE PRISHTINA DHE BALLKANI



## THAÇI TAKOHET ME ERDOGANIN: KOSOVA DHE TURQIA DO TA FUQIZOJNË PARTNERITETIN STRATEGJIK

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i shoqëruar edhe nga ish-ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli,

është takuar të dielën në Stamboll me presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan. Presidenti Thaçi ka thënë se

Kosova dhe Turqia gëzojnë raporte miqësore dhe do ta fuqizojnë më tej partneritetin strategjik

## BASKIN: MARRËVESHJA KOSOVË - SERBI DO TA PËRFSHIJË NJOHJEN RECIPROKE



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Cikloni Ianos godet Greqinë

ATHINË, 20 SHTATOR - Dy persona kanë vdekur dhe një person është raportuar i zhdukur, pasi një stuhi e madhe goditi Greqinë. Cikloni Ianos shkaktoi vërshime të mëdha dhe

shkatërroi shumë pjesë të Athinës, raporton BBC. Kryeministri grek, Kyriakos Mitsotakis, ka dërguar disa zyrtarë qeveritarë në zonat më të goditura në këtë rajon.

Pamjet në rrjete sociale kanë shfaqur stuhi të mëdha në ishujt e Kefalonia dhe Zakynthos të premtën. Të gjitha fluturimet dhe transportet tokësore janë anuluar

dhe turistët janë këshilluar të qëndrojnë brenda. Ekipet e shpëtimit raportohet se janë duke vazhduar kërkimet për viktime të tjera të mundshme.



## ShBA-ja kthen sanksionet e OKB-së ndaj Iranit, pavarësisht prej kundërshtimeve

UASHINGTON, 20 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara kanë rivendosur në mënyrë të njëanshme të gjitha sanksionet e Kombeve të Bashkuara kundër Iranit, pavarësisht prej kundërshtimit nga aleatët më të ngushtë evropianë të Uashingtonit dhe pasigurisë për ndikimin e tyre. Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, më 19 shtator njoftoi për të ashtuquajturën kthim mbrapa të sanksioneve të OKB-së ndaj Iranit. "Nëse vendet anëtare të OKB-së dështojnë t'i përmbushin detyrimet e tyre për të zbatuar këto sanksione, Shtetet e

Bashkuara janë të gatshme t'i përdorin autoritetet tona të brendshme për të imponuar pasoja për ato dështime dhe për të siguruar që Irani të mos korrë përfitimet e aktivitetit të ndaluar nga OKB-ja. Në ditët në vijim Shtetet e Bashkuara do të shpallin një sërë masash shtesë për ta forcuar zbatimin e sanksioneve të OKB-së dhe për t'i kërkuar shkelësit e përgjegjësisë", ka thënë Pompeo. Masa e ShBA-së i hap rrugën një përplasjeje të madhe në Kombet e Bashkuara, ku Uashingtoni e gjen veten gjithnjë e më të izoluar mes



tensioneve me Iranin dhe palët e tjera të marrëveshjes bërthamore të vitit 2015, i njohur zyrtarisht si Plani i Përbashkët Përgjithshëm i Veprimit (JCPOA). "Amerikanët

veprojnë si ngacmues dhe vendosin sanksione... Komuniteti botëror duhet të vendosë se si të veprojnë ndaj ngacmimit" i tha ministri i Jashtëm iranian Mohammad

Javad Zarif televizionit shtetëror iranian disa orë para njoftimit. Presidenti Donald Trump u tërhoq nga Plani i Përbashkët i Veprimit më 2018 dhe vendosi sërish sanksionet e ShBA-së ndaj Iranit, duke bërë që Teherani t'i shkelë angazhimet e tij bërthamore. Palët e mbetura në marrëveshjen bërthamore të Iranit janë përpjekur ta shpëtojnë marrëveshjen, duke hedhur poshtë përpjekjen nga Uashingtoni për të shkaktuar një kthim të sanksioneve të OKB-së ndaj Teheranit për shkeljen e angazhimeve të tij bërthamore.

## Rama thotë se çështja e detit me Greqinë duhet të shkojë drejt Gjykatës Ndërkombëtare

TIRANË, 20 SHTATOR - Marrëdhëniet shqiptaro-greke, marrëveshja e detit e vitit 2009 dhe arritja e një pakti të ri për ZEE, kanë qenë pikat kryesore të një intervistë që ka dhënë kryeministri shqiptar, Edi Rama, në stacionin televiziv grek Mega. "Kaluam midis një përvojë absurde tipike ballkanike dhe klasike të një patriotizmi të rreme, e cila ndezi formën më ekstreme të zjarrit, pas fjalimit të kryeministrit tuaj në parlament, gjatë diskutimit të marrëveshjeve detare me



Italinë dhe Egjiptin për zonat detare. U bë një diskutim në lidhje me të drejtën e vendit për të zgjeruar ujërat territoriale në 12 milje. Rasti midis Greqisë dhe Shqipërisë është i veçantë, sepse të dy vendet nuk mund të kryejnë zgjerimin e tyre në mënyrë të njëanshme, pa një marrëveshje midis tyre, sepse natyrisht një gjë e tillë nuk është e mundur", ka thënë ai. Edhe njëherë kryeministri Rama ka shprehur mendimin se Shqipëria dhe Greqia duhet të arrijnë në një marrëveshje duke u treguar vendin patriotëve dhe

nacionalistëve të çmendur dhe të rremë në të dy vendet siç i ka quajtur ai dhe një nga mënyrat është një marrëveshje e mirëbesimit duke ngritur çështjen në një gjykatë ndërkombëtare me një rezultat objektiv. Një mendim që siç ka theksuar do ta diskutojë me ministrin e jashtëm kur të vizitojë së shpejti Tiranën. Rama është pyetur edhe për miqësinë e tij me presidentin Erdogan, nëse ai ka ndërhyrë për marrëveshjen e detit të vitit 2009 si dhe për konfliktin e sotëm greko-turk.

## Zyrtarët e shëndetësisë i bëjnë thirrje publikut ta bëjë vaksinën e gripit

NJU JORK, 20 SHTATOR - Zyrtarët e shëndetësisë po i bëjnë thirrje publikut që ta bëjë vaksinën e gripit këtë vit për ta shmangur mundësinë e përballjes me koronavirusin dhe gripin në të njëjtën kohë. Të dyja sëmundjet janë shumë ngjithëse dhe kanë simptoma të ngjashme. Por gripi është sezonal, ndërsa Covid-19 nuk duket të jetë i lidhur me stinën, ndërsa përhapet në gjithë botën. Megjithëse ende nuk ka dalë një vaksinë për Covid-19,

vaksina për gripin ka qenë e disponueshme prej dekadash. E vetmja mënyrë për të përcaktuar nëse dikush ka njërin ose të dyja këto sëmundje, është përmes testeve laboratorike. Gary Simon, drejtor i Divizionit të Sëmundjeve Infektive në Universitetin "George Washington" në Uashington, i tha gazetës "Washington Post" se perspektiva e një lufte ndaj dy sëmundjeve njëkohësisht e bën vitin 2020 "shumë të vështirë".

Sipas Universitetit "Johns Hopkins", deri tani në gjithë botën ka 30.5 milionë raste me rreth 1 milion të vdekur. Amerika ka numrin më të lartë të të infektuarve me 6.7 milionë, pasuar nga India me 5.3 milionë dhe Brazili me 4.5 milionë. Vendet evropiane njoftuan për masa të reja kufizuese më 18 shtator, një ditë pasi Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëroi se infeksionet kanë filluar të përhapen përsëri në kontinent me "ritme alarmante".



# Thaçi takohet me Erdoganin: Kosova dhe Turqia do ta fuqizojnë partneritetin strategjik

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i shoqëruar edhe nga ish-ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, është takuar të dielën me presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, në Stamboll. Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova dhe Turqia gëzojnë raporte miqësore dhe do ta fuqizojnë më tej partneritetin strategjik



**EPOKA ERE** Faton DËRMAKU

STAMBOLL, 20 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është takuar të dielën me presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, në Stamboll. Në një postim në rrjetin social "Twitter", Thaçi ka paralajmëruar fuqizim të partneritetit me Turqinë, të cilin

e ka quajtur strategjik. "Mirënjohës presidentit Erdogan për mikpritjen e ngrohtë dhe bisedën frytdhënëse rreth të gjitha çështjeve të interesit reciprok, përfshirë bashkëpunimin dypalësh, çështjet rajonale si dhe globale. Shtetet tona gëzojnë raporte miqësore dhe do ta fuqizojnë më tej partneritetin strategjik", ka

shkruar presidenti Thaçi. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe kryetari i partisë Aleanca Kosova e Re (AKR), ish-ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. Për këtë takim ka folur edhe Pacolli. Ai ka thënë se presidenti Erdogan është mik dhe aleat i madh i Kosovës. "Sot në Stamboll së bashku me presidentin Thaçi zhvilluam një takim të shkëlqyeshëm me presidentin turk Erdogan. Presidenti Erdogan është një mik dhe aleat i madh i Kosovës i cili ka mbështetur pavarësinë

dhe njohjen tonë që nga dita e parë kur shpallëm pavarësinë e Kosovës. Miqësia dhe partneriteti ynë do të jenë më të fuqishëm", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook". Ditë më parë, pas arritjes së marrëveshjes në Shtëpinë e Bardhë, ambasada turke në Prishtinë reagoi, duke thënë se Turqia e kundërshton hapjen e ambasadës së Kosovës në Jerusalem. "Turqia, si një nga vendet e para që njohu Kosovën, gjithashtu që ka siguruar një mbështetje të madhe për

përpjekjet drejt njohjes ndërkombëtare të këtij vendi që nga fillimi, nuk e sheh të drejtë që ky proces të ndërtohet në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, veçanërisht mbi vuajtjet e popullit palestinez, territoret e të cilin janë nën okupim", ka njoftuar Ambasada e Turqisë në Prishtinë në një postim në mediat sociale. Zotimet e Kosovës dhe Serbisë për hapjen e ambasadave në Jerusalem i ka kritikuar edhe Bashkimi Evropian.



## Baskin: Marrëveshja Kosovë - Serbi do ta përfshijë njohjen reciproke

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Mark Baskin, profesor amerikan që ligjëron Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Politikat Publike në Universitetin Amerikan në Kosovë (AUK), beson se Kosova dhe Serbia do të arrijnë marrëveshje finale në një të ardhme jo të largët, e cila do ta përfshijë njohjen reciproke.

Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", profesori Baskin thotë se, pavarësisht kush fiton zgjedhjet presidenciale në ShBA, nuk do të ketë ndryshim në parimet e përgjithshme të përkrahjes për Kosovën, por dallimin, sipas tij, kandidatët mund ta kenë vetëm në qasje. Ai thotë se Kosova duhet të marrë shembull Kroacinë për unitetin e domosdoshëm politik në politikën e jashtme. Duke folur për marrëveshjen e arritur në Uashington, Baskin ka theksuar se Kosova nga kjo marrëveshje ka fituar. "Mendoj

se Kosova fitoi nga kjo marrëveshje njohjen nga Izraeli që është një e arritur shumë e madhe. Kjo pikë tregon qartë perspektivën për të ardhmen në tërë këtë proces, pasi demonstroi që Uashingtoni ishte në anën e Kosovës në këtë proces. Dhe prandaj, edhe ofruan këtë marrëveshje. Në këtë kuptim mendoj se ishte një fitore e madhe. Në anën tjetër, si në Uashington, Bruksel apo Berlin e kanë të gjithë të qartë se çdo marrëveshje e nënshkruar në Uashington kërkon edhe mbështetjen e BE-së dhe mendoj se ky ishte një hap i mirë përpara", është shprehur ai.

Baskin ka thënë se çfarëdo marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet ta ketë bekimin e Uashingtonit dhe të Brukselit. "Çfarëdo marrëveshje duhet ta ketë bekimin e Uashingtonit dhe të Brukselit. Në këtë rast Kosova



ka synim integrimet euroatlantike duke përfshirë anëtarësimin në BE, e këtua ka nevojë për njohjen nga pesë vendet që nuk e kanë njohur e

në anën tjetër Kosova ka pasur përvojë të jashtëzakonshme me ShBA-në, pasi që kjo e fundit e ka mbështetur atë që nga vite '80, që nga administrata e

Bushit. Kjo nënkupton që ShBA-ja ka treguar simpati dhe ka ofruar mbështetje për të drejtat e njeriut në Kosovë", ka deklaruar Baskin.



DORËZIMI I DOSJEVE TË GJYKATËS SPECIALE NË ORGANIZATËN E OVLUÇK-së  
KA NXITUR REAGIME TË SHUMTA

# HARADINAJ: PUBLIKIMI I DOSJEVE TË SPECIALES NUK I NDIHMON KOSOVËS

Publikimi i dosjeve të Gjykatës Speciale është kritikuar nga vendorët dhe ndërkombëtarët. Zyrtarët vendorë dhe ndërkombëtarë kanë vlerësuar se kjo nuk është në favor të drejtësisë. Ndërkaq ish-kryeministri i Kosovës, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë të dielën se kjo situatë po krijon padrejtësisht përshtypjen se Kosova është rreshtuar në anën e kundërt të drejtësisë. Ai ka porositur që kushdo që has në dokumente sensitive të hetuesisë e të gjykatave, menjëherë duhet t'ua dorëzojë institucioneve përgjegjëse. “Zhvillimet e fundit rreth kësaj teme, që po ushqejnë debatin mediatik, nuk i ndihmojnë Kosovës, të vërtetës së saj dhe drejtësisë vendore e ndërkombëtare”, ka thënë Haradinaj

“Kushdo që has në dokumente sensitive të hetuesisë e gjykatave menjëherë duhet t'ua dorëzojë institucioneve përgjegjëse e jo ta ushqejë vazhdimin e spektakleve mediatike që dëmtojnë zhvillimin e drejtësisë dhe zbatimin e ligjit për të gjithë. Kosova si viktimë përballë agresorit, UÇK-ja dhe populli i Kosovës janë angazhuar gjithmonë për t'u pozicionuar në anën e drejtësisë, të vërtetës dhe të drejtës ndërkombëtare. Kështu do të mbetet gjithmonë”, ka vlerësuar ai.

Me dorëzimin e këtyre dosjeve në zyrat e OVLUÇK-së janë shprehur të shqetësuar edhe ambasadorët e vendeve të Quintit. Të premtën, përmes një deklarate për medie, ata kanë përgëzuar Zyrën e Prokurorit

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Zyrtarët vendorë dhe ndërkombëtarë kanë kritikuar dorëzimin e mijëra dosjeve të Gjykatës Speciale në zyrat Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Sipas tyre, një veprim i tillë është

kundër drejtësisë dhe i dëmshëm për Kosovën.

Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, e ka quajtur spektakël dashakeq çështjen e mbi 4 000 dosjeve të Gjykatës Speciale që iu dorëzuan në mënyrë anonime OVLUÇK-së.

Ish-kryeministri i Kosovës ka

thënë se kjo situatë po krijon padrejtësisht përshtypjen se Kosova është rreshtuar në anën e kundërt të drejtësisë. “Me shumë shqetësim po ndjek spektaklin dashakeq të dosjeve që po e krijojnë padrejtësisht përshtypjen se Kosova është rreshtuar në anën e kundërt të drejtësisë. Zhvillimet e fundit rreth kësaj

teme, që po ushqejnë debatin mediatik, nuk i ndihmojnë Kosovës, të vërtetës së saj dhe drejtësisë vendore dhe ndërkombëtare”, ka shkruar Haradinaj të dielën në profilin e vet në “Facebook”.

Ai ka thënë se kushdo që has në këto dokumente duhet t'ua dorëzojë organeve përgjegjëse.

misioneve të Francës, të Gjermanisë, të Italisë, të Mbretërisë së Bashkuar dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ndërsa javën që lamë pas, për herë të dytë, një person i pidentifikuar ka sjellë dosje të reja të Speciales në zyrat e OVLUÇK-së. Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, në prani të avokatit Tomë Gashi, ka deklaruar se ato dosje ua kanë dorëzuar hetuesve të Gjykatës Speciale. Në një konferencë për medie, Gucati ka thënë se ato dokumente janë të Gjykatës Speciale. "Sot kemi pasur një vizitë të pakëndshme në OVLUÇK. Këtu kanë ardhur hetuesit e Gjykatës Speciale. Me këshillën e avokatit Gashi këto materiale i dorëzuam. Tashmë, më në fund, është vërtetuar se këto dokumente janë të Gjykatës Speciale apo të Dhomave të Specializuara në Hagë", ka thënë Gucati.

Kurse avokati Tomë Gashi ka thënë se duke u bazuar në logon e Gjykatës Speciale, vërtetohet se këto janë dokumente origjinale të saj. "Vërtetohet se këto janë dokumentet e Gjykatës Speciale. Vërtetohet se këto dokumente janë të Gjykatës Speciale. Me këshillën time kryetari ka vendosur që tash t'ua dorëzoj. Në bazë të logos e shikoni që këto dokumente janë të Gjykatës Speciale, apo të Dhomave të Specializuara në Hagë", ka thënë Gashi. Sipas tij, në dokumentet e publikuara në media duhet pasur kujdes për publikimin e emrave dhe mbiemrave që gjenden në dokumente.

Identiteti i personit, i cili më 7 dhe 16 shtator ka dërguar në këtë organizatë me mijëra dosje me dëshmi dhe emra dëshmitarësh, vazhdon të jetë anonim.

Ndërkohë, Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ka nisur hetimet për "rrjedhjen" e dokumenteve të pretenduara konfidenciale.

Dhoma e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar janë themeluar pesë vjet më parë nga Kuvendi i Kosovës për t'i hetuar krimet e pretenduara kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe vepra të tjera penale në lidhje me pretendimet e përfshira në Raportin e Këshillit të Evropës të vitit 2011. Deri më tani Gjykata Speciale ka ftuar për intervistim qindra ish-pjesëtarë të UÇK-së, qoftë si dëshmitarë apo si të dyshuar.

Më 24 qershor Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ka njoftuar se më 24 prill ka paraqitur një aktakuzë për shqyrtim për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit kundër presidentit Hashim Thaçi, kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, dhe disa të tjerëve, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë. Deri më tani asnjë aktakuzë nuk është konfirmuar ose hedhur poshtë publikisht. Gjyqtari ka gjashtë muaj për të konfirmuar ose hedhur poshtë aktakuzën.

# Haxhiu: Prapa kazinove në Karaçevë ka qëndruar klasa politike e lidhur me pushtetin e pas 6 tetorit 2019

**PRISHTINË, 20 SHTATOR (ER)** - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka thënë se para zgjedhjeve LV-ja e LDK-ja vetë proklamoheshin si 'koalicioni i shpresës', ndërsa pas zgjedhjeve doli të jetë koalicioni i kazinove, kontrabandës e mashtrimit, që në brezin kufitar me Serbinë mbylli shkollat e hapi kazinotë. Ky reagim i Haxhiut vjen pas aksionit të policisë në Karaçevë. "Aksioni i Policisë së Kosovës në Karaçevë menjëherë pas interpelancës së ministrit Agim Veliu në Kuvendin e Kosovës, argumenton më së miri se prapa kazinove në Karaçevë ka qëndruar klasa politike e lidhur me pushtetin e pas 6 tetorit 2019. Sikur LV-ja e LDK-ja të mos përplaseshin mes vete për 'mustaqe e pafytyrësi', sigurisht se puna e kazinove në Karaçevë do të vazhdonte pa pengesë, ashtu siç funksionuan deri më tani në qeverinë Kurti e Hoti për

muaj të tërë", ka shkruar Haxhiu në llogarinë e vet në "Facebook".


Ai ka shtuar se pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, Karaçeva është shndërruar në oazë të krimit, bixhozit e kontrabandës. "Komuna e Dardanës/Kamenicës që udhëhiqet nga kryetari Qëndron Kastrati, i cili fitoi votat si kandidat i LV-së për kryetar komune, në brezin kufitar me Serbinë ka mbyllur shkollat dhe njëkohësisht nuk ka ndaluar ndërtimin dhe funksionimin e kazinove në fshatin Karaçevë. Qytetarët duan ta dinë: Pse pasi fitoi LV-ja në Dardanë/Kamenicë dhe në nivel të Kosovës, lulëzuan kazinotë në fshatin Karaçevë që ndodhet në brezin kufitar me Serbinë? Pse komuna e Dardanës/Kamenicës lejoi mbylljen e shkollave në brezin kufitar me Serbinë dhe nuk ndaloi ndërtimin e kazinove në Karaçevë? Objektet e kazinove

atje nuk u ndërtuan brenda natës. Pse nuk pat reagim të institucioneve lokale e as qendrore? Funksionimi i kazinove në Karaçevë ishte i njohur për të gjithë. Atëherë pse Qeveria Kurti dhe Hoti lejuan funksionimin e tyre pa pengesë gjatë kësaj kohe?", ka shkruar deputeti Haxhiu.

Të premtën rreth mesnatës Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore të Gjilanit dhe Inspektoratin Policor, ka arrestuar 35 persona, në mesin e tyre 12 zyrtarë policorë, të përfshirë në aktivitete kriminale, si dhe ka sekuestruar aparate të lojërave të fatit dhe prova materiale.

Në këtë aksion u rrënuan edhe 12 objekte ku zhvillohej veprimtaria e bixhozit dhe lojërave të fatit. Ky aksion u realizua pas një viti hetimesh, ka njoftuar Prokuroria Themelore e Gjilanit.

Special të Republikës së Kosovës për respektimin e autoritetit të Zyrës së Prokurorit të Dhomave të Specializuara për ta hetuar zbulimin e mundshëm të paligjshëm të dokumenteve dhe informatave të besueshme, njëkohësisht duke ofruar ndihmën e saj sipas nevojës. Gjithashtu, përmes kësaj deklarate ambasada e Francës, e Gjermanisë, e Italisë, e Mbretërisë së Bashkuar dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës u kanë bërë thirrje Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës që të kundërshtojnë çdo përpjekje për të prishur ose zhvlerësuar misionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) dhe të Zyrës së Prokurorisë së Dhomave të Specializuara (ZPDhS), si dhe që të sigurojnë që ato ta kryejnë misionin e tyre në përputhje me Kushtetutën. "Në këtë vazhdë, e përgëzojmë kryetaren e Kuvendit të Kosovës që e ka përcjellë propozimin e Presidentit për ndryshim të Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese në Hagë, si dhe Zyrën e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës për respektimin e autoritetit të ZPDhS-së për ta hetuar zbulimin e mundshëm të paligjshëm të dokumenteve dhe informatave të besueshme, njëkohësisht duke ofruar ndihmën e saj sipas nevojës", thuhet në deklaratën e përbashkët të shefave të



## Drenasi me disa aktivitete shënon Ditën Botërore të Pastrimit

**DRENAS, 20 SHTATOR (ER)** - Komuna e Drenasit edhe këtë vit ka shënuar Ditën Botërore të Pastrimit me disa aktivitete, ku janë pastruar hapësirat publike në parkun "Të Pishat" në Glllobar dhe në qendër të qytetit në Drenas. Këtij aktiviteti i janë bashkëngjitur Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, zyrtarë nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria për Kulturë, Rini e

Sport, nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal dhe nga Kompania "Pastrimi". Dita Botërore e Pastrimit në Drenas është shënuar me moton "një qytet i pastër dhe pa mbeturina". Drejtresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, Lumnije Krapu, ka thënë se Komuna e Drenasit në vazhdimësi ka qenë e përkushtuar për mbrojtje të mjedisit, duke pastruar hapësirat publike dhe largimin e deponive ilegale. Drejtresha

Krapu u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të kujdesen për mjedisin, sepse kujdesi ndaj natyrës është kujdesi ndaj shëndetit dhe shoqërisë në përgjithësi. Në shënimin e Ditës Botërore të Pastrimit është bërë pastrimi i pishave në fshatin Glllobar, ku janë larguar të gjitha mbeturinat, po ashtu është bërë edhe pastrimi i hapësirave publike në Drenas si dhe janë larguar disa deponi ilegale në vendbanime.



## Mbyllen edhe tetë lokale në Ferizaj nga Inspektorati

**FERIZAJ, 20 SHTATOR (ER)**- Inspektorati i Komunës, bashkë me Njësinë kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore të Policisë së Kosovës, në aksionin që nisi ditë më parë, ka vazhduar edhe ditëve të vikendit, me dyshimin e arsyeshëm për ushtrimin e veprimtarive devijante, mungesën e dokumentacionin përkatës, mosplotësimin e kushteve higjieno-teknike.

Inspektorati ka mbyllur dy lokale në rrugën "Qamil Ilazi", tri lokale në "Shën Tereza", dhe tri lokale me nga një në rrugët "Remzi Hoxha", "Rexhep Bislimi", "Hamëz Jashari". "Inspektorati i Komunës me mbështetjen si



asnjëherë më parë të Kryetarit të Komunës, Agim Aliu, janë të vendosur në vendosjen e rregullit, ligjshmërisë në çdo cep të Ferizajt, me kontrollet e rregullta inspektuese", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.

## Asfaltohen rrugët në Shtupel të Klinës, riparohen në Caravik

**KLINË, 20 SHTATOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka qëndruar në fshatin Shtupel, ku ka parë nga afër punimet për asfaltimin e segmenteve rrugore në lagjet Temaj dhe Kerellaj.

Ky projekt po realizohet në kuadër të investimeve komunale për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe, po ashtu, do të vazhdojnë punimet për asfaltimin e segmenteve të tjera rrugore, investime këto shumë të rëndësishme dhe të nevojshme për banorët e këtij lokaliteti.

Ndërsa në fshatin Caravik, Ministria e Infrastrukturës, në kuadër të mirëmbajtjes verore të rrugëve, pas kërkesës së

Komunës së Klinës, po vazhdon riparimin e rrugës kryesore që është në menaxhim të ministrisë.



## Deri më sot në Malishevë janë infektuar nga Covidi 240 persona

**MALISHEVË, 20 SHTATOR (ER)** - Në territorin e Komunës së Malishevës të dielën janë shëruar tre persona të cilët kanë qenë të prekur me Covid-19, ndërsa është regjistruar edhe një rast i ri. Këto të dhëna janë të konfirmuara në komunikimin e rregullt në mes të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të

Kosovës dhe Komunës së Malishevës. Në Komunën e Malishevës aktive janë 21 raste me Covid-19.

Gjendja e përgjithshme me Covid-19 në territorin e Komunës së Malishevës është kjo: Nga data 14 mars e deri më sot, me Covid-19 janë prekur 240 persona, prej tyre

197 janë shëruar, 22 persona kanë vdekur, ndërsa raste aktive janë 21.

Shtabi Komunal që merret me menaxhimin e pandemisë Covid-19 u bën thirrje të gjithë qytetarëve që ta vazhdojnë zbatimin e masave për t'u mbrojtur nga ky virus, pasi kjo është mënyra e vetme e luftimit të këtij virusi.



## Shkolla e Mesme "Anton Çetta" në Skenderaj bëhet me sallë të edukatës fizike



**SKENDERAJ, 20 SHTATOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se nxënësit e Shkollës së Mesme të Lartë Profesionale "Anton Çetta" po bëhen me sallë të edukatës fizike, e cila ka munguar me vite të tëra.

Kryetari Jashari ka thënë se kjo do të jetë një palestër moderne e cila do të jetë në shërbim të

nxënësve të kësaj shkolle nga muaji tetor i këtij viti. "Krahas punimeve që po bëhen për ndërtimin e palestres, punëkryesi në mënyrë vullnetare dhe stafi i shkollës me drejtorin e kësaj shkolle kanë bërë edhe rregullimin e parkingjeve dhe hapësirave të gjelbra përreth shkollës", ka bërë me dije kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari.

# Në ditët e ardhshme do të jetë gati Spitali për Covid-19

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka paralajmëruar të dielën se në ditët e ardhshme ministria që drejton do ta bëjë gati 'Spitalin për Covid-19' me 500 shtretër në Prishtinë. Ai ka bërë me dije se janë në komunikim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë për sigurimin e vaksinës së mundshme kundër Covid-19. Ministri Zemaj ka theksuar se mosvotimi i Projektligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike është duke vështërësuar përpjekjen e MSh-së dhe të institucioneve të tjera shëndetësore kundër virusit

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 SHTATOR - 'Spitali për Covid-19' me 500 shtretër do të jetë gati shumë shpejt. Kështu ka bërë me dije të dielën ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj. "Përderisa shtetet evropiane po ballafaqohen me përhapjen e shpejtë të virusit dhe raportojnë numër të lartë të infeksioneve me Sars Covid-19, ne po përgatitemi për çdo skenar. Ministria e Shëndetësisë në ditët në vijim do ta bëjë gati 'Spitalin për Covid-19',

me 500 shtretër në Prishtinë", ka thënë Zemaj.

Zemaj ka thënë se janë në komunikim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë për sigurimin e vaksinës së mundshme kundër Covid-19. Ai ka folur edhe për mosmiratimin e Projektligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike në Kuvendin e Kosovës. "Po komunikojmë me COVAX/OBSH për sigurimin e vaksinës së mundshme kundër Covid-19, si dhe po bëjmë veprimet e nevojshme në pajtim me situatën. Ne jemi nën presion

edhe nga bizneset si pasojë e mosvotimit të Projektligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike e që po na vështërson përpjekjen tonë kundër virusit. Mosmiratimi i Projektligjit po rrezikon mbijetesën e shumë bizneseve dhe mirëqenien e qytetarëve. Është shqetësuese dhe për keqardhje, sepse po ndodh për shkak të tekeve të disa deputetëve. Në parandalimin e përhapjes së virusit duhet kujdes, shumë kujdes. Kërkojmë respektim i masave parandaluese", ka thënë ministri Zemaj.

## Dy të vdekur dhe 61 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 464 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 61 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast nga Spitali Rajonal i Gjilanit dhe 1 rast nga Mjekimi Intensiv Qendror-Covid). Numri total i rasteve pozitive është 15 063 raste nga 62 011 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-

2 dhe 613 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 119 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri me sot është gjithsej 12 570 raste, kurse numri i rasteve aktive është 1 880. Rastet pozitive në 24 orët e fundit janë nga: komuna Prishtinë 19 raste, komuna Vushtri 8 raste, komuna Prizren 7 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Gjilan 4 raste, komuna Pejë 4 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Istog 3 raste, komuna Deçan 2 raste, dhe me nga një rast komunat Drenas, Malishevë, Obiliq, Podujevë, Skenderaj dhe Suharekë.



## Lëvizja Vetëvendosje shpall zgjedhjet e brendshme

PRISHTINË, 20 SHTATOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka shpallur zgjedhjet e brendshme të përgjithshme. Nga 20 shtatori secili anëtar i kësaj lëvizje, dhe kurdo që është anëtarësuar, do të ketë të drejtë për të votuar e për t'u kandiduar. "Zgjedhjet do të jenë të drejtpërdrejta, të lira e demokratike. Në fund të këtij procesi do të kemi struktura edhe më të fuqishme ashtu siç e kemi edhe mbështetjen e jashtëzakon-

shme të qytetarëve. Në 30 qendra të Lëvizjes në Kosovë e 13 qendra në mërgatë, anëtarët e Lëvizjes do të kenë mundësi që përmes parimit 'një anëtar, një votë' t'i zgjedhin kryesitë e kryetarët e pikave nëpër lagje e fshatra, t'i propozojnë kandidatët që vlerësojnë më së shumti apo edhe të vetëpropozohen", është bërë me dije në njoftimin për media të LV-së. Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se të gjithë anëtarët do të

kontaktohen për të marrë pjesë në zgjedhje. "Ju që mbështetni Lëvizjen, por nuk jeni anëtarësuar ende, vizitoni zyrat e Lëvizjes Vetëvendosje në komunën tuaj dhe anëtarësohuni që të bëheni pjesë e këtij procesi demokratik. Lëvizja fton të gjithë anëtarët që të bashkohen në këtë proces zgjedhor. Bashkë në organizim, bashkë në drejtim!", është theksuar në njoftimin për media të LV-së.



# Gastronomët të pakënaqur, thyejnë pjata para qeverisë

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Duke thyer pjata para objektit të Qeverisë së Kosovës, Shoqata e Gastronomëve e Kosovës ka shprehur pakënaqësitë për mospërkrahjen financiare nga institucionet. Ata kanë kërkuar edhe shfuqizimin e masave ndaj

gastronomisë. Përmes këtij aksioni, kryetari i kësaj shoqate, Petrit Kllokoqi, u ka bërë thirrje edhe gastronomëve të tjerë të Kosovës që t'i bashkëngjiten protestës më 25 shtator në sheshin 'Skënderbeu' para Qeverisë së

Kosovës. "Përmes këtij akti simbolik po shprehim pakënaqësitë tona ndaj mospërkrahjes financiare nga institucionet e Kosovës si dhe mosshfuqizimin e masave ndaj gastronomisë. Po ashtu, iu bëjmë thirrje gjithë

gastronomëve që t'i bashkëngjiten këtij aksioni simbolik, edhe protestës më 25 shtator në orën 14:00, para Kuvendit dhe qeverisë", ka pohuar Kllokoqi. Për shkak të mungesës së kuorumit, Kuvendi i Kosovës ka

dështuar ta miratojë Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike nga pandemia Covid-19. Kafenetë dhe restorantet në Kosovë funksionojnë vetëm deri në orën 22:30 në mbrëmje, masë kjo e vendosur nga qeveria për shkak të pandemisë.



## Vetëvendosja thotë se Serbia forcohet me marrëveshjet infrastrukturore

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje kanë thënë të dielën se Kosova nuk po sillet si shtet karshi marrëveshjes me Serbinë të arritur në Shtëpinë e Bardhë.

Drejtuues të partisë më të madhe opozitare në Kosovë theksojnë se 'marrëveshja për stabilizim ekonomik në mes Kosovës dhe Serbisë është negociuar në kurriz të Kosovës'.

Në një konferencë për media, anëtari i kësaj partie, Avni Zogiani, ka thënë se me pikën për autostradën, hekurudhën dhe linjën ajrore që lidhë Kosovën dhe Serbinë si dhe pikat e tjera, Kosova po vazhdon të "sillet si autoritet joshtetëror". Sipas tij, marrëveshjet infrastrukturore vetëm e kanë forcuar Serbinë. "Kur flitet për hekurudha, autostrada, në këto marrëveshje nuk gjenden referenca për pikat kalimtare si



pika kufitare. Vazhdojmë të pranojmë një proces që thëllon sjelljen e Kosovës si autoritet joshtetëror. Marrëveshjet

infrastrukturore forcojnë jashtëzakonisht rolin e Serbisë në rrjetin ndërkombëtar të transportit. Serbia do të jetë

vendi ku do të kalojnë dy korridore", ka thënë Zogiani. Ai ka shtuar se qeveria Hoti këto projekte i ka reduktuar në

marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë. "Do të thotë se zhvillimi i Kosovës detyrohet nëpërmjet Serbisë. Gjithçka për zhvillim infrastrukturor shihet përmes prizmit të Serbisë", ka shtuar ai. Marrëveshja e 4 shtatorit në Uashington për, siç është thënë, normalizimin ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, parasheh zbatimin e një sërë marrëveshjesh të arritura tashmë, siç është ajo për autostradën në mes të Kosovës dhe Serbisë, ajo për hekurudhat dhe për linjën ajrore.

Në praninë e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë nënshkruar, veç e veç, dokumente për normalizim ekonomik prej 16 pikash, të cilat janë konsideruar si marrëveshje apo zotime të njëanshme.



## Bizneset vazhdojnë veprimtarinë me humbje, shteti hesht

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Kompanisë "Laberion", e cila merret me prodhimin e lëngjeve në Kosovë, si pasojë e pandemisë me Covid-19 i janë shkaktuar humbje deri në 5 milionë euro. Pronari i kësaj kompanie, Bashkim Osmani, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se shitja e produkteve të tyre ka rënë në 40 për qind. "Në muajin korrik kemi pasur 18 për qind rënie të shitjes apo qarkullimit, në muajin gusht kemi pasur rënie 22 për qind të shitjes, ky muaj (shtator) do të jetë me humbje edhe më të mëdha. Deri në fund të vitit llogarisim që do të kemi rënie 40 për qind, që në vlerë monetare humbjet mund të jenë 4 deri në 5 milionë euro", thotë ai. Në kompaninë "Laberion" janë të punësuar 130 punëtorë.

Osmani thotë se deri më tani nuk ka larguar nga puna asnjë punëtor, por ai kërkon nga autoritetet e Kosovës që t'i ndihmojnë bizneset, pasi që edhe vendet e punës nuk do të mund të jenë të sigurta në të ardhmen.

### Afër 900 milionë euro më pak qarkullim

Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës dhënë "Radion Evropa e Lirë", bizneset në Kosovë kanë pasur afër 900 milionë euro më pak qarkullim gjatë periudhës mars-korrik krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Drejtori i Përgjithshëm i

Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, tha për "Radion Evropa e Lirë" se bizneset në Kosovë kanë shënuar rënie të të hyrave dhe kjo, sipas tij, është mjaft shqetësuese për ekonominë e vendit. "Që nga fillimi i pandemisë, nga muaji mars e deri në korrik, bazuar në të dhënat statistikore të ATK-së, rezultojnë se kemi pasur rënie të qarkullimit prej 900 milionë eurosh, pra qarkullim më i ulët që, shprehur në përqindje, i bie 22 për qind kemi rënie në periudhën mars-korrik 2020 në raport me periudhën e njëjtë në vitin 2019", thotë Murtezaj.

### Murtezaj: Të ndërhyjë shteti, gjendja financiare e bizneseve po rëndohet

Murtezaj shton se për ta nxitur zhvillimin ekonomik duhet të ketë ndërhyrje nga ana e shtetit, në kuptimin e ngritjes së konsumit si promotor i zhvillimit ekonomik pasi, në të kundërtën, sipas tij, bizneset futen në krizë. "Ka disa muaj që po proklamohet Projektligji për rimëkëmbje ekonomike, i cili do ta lehtësonte këtë rënie të qarkullimit të të hyrave të biznesit, por ky (projektligj) nuk u arrit të miratohet në kuvend. E gjithë kjo nënkupton se do të kemi përkeqësim të shtuar gjatë muajve në vijim, nëse vetëm nuk do të ketë ndërhyrje nga ana e shtetit", thotë ai.

Kuvendi i Kosovës për herë të dytë të enjten, më 17 shtator, ka dështuar ta votojë Projektligjin për rimëkëmbje ekonomike



Covid-19. Ky projektligj, që më 22 korrik u miratua në Qeverinë e Kosovës, kap vlerën prej 385 milionë eurove. Projektligji synon që përmes politikave fiskale dhe monetare t'iu ndihmojë bizneseve pas humbjeve të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit. Votimi i këtij projektligji, po ashtu, do t'iu mundësonte qytetarëve kontributpagues të tërheqin 10 për qind të mjeteve nga llogaria e tyre në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

### Rukiqi: Po humben vende pune dhe bizneset po futen në procedura të falimentimit

Përfaqësuesit e bizneseve në vazhdimësi u kanë bërë thirrje autoriteteve të Kosovës që sa më

shpejt të ndihmojnë në rimëkëmbjen ekonomike, pasi që çdo vonesë, sipas tyre, do të sillte probleme më të mëdha për bizneset dhe rrezik të falimentimit të tyre.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në një konferencë që ka mbajtur javën që lamë pas, iu ka bërë thirrje deputetëve që urgjentisht të marrin masa konkrete për rimëkëmbje ekonomike, pasi që rreziqet janë të mëdha në ekonomi. "Nëse nuk intervenohet me disbursim të mjeteve në ekonomi gjatë muajt shtator dhe muajin tetor, atëherë kolapsi ekonomik është i pashmangshëm dhe do të përcillet me humbjen e shumë vendeve të punës. Jemi duke folur për mbyllje të mijëra vendeve të punës dhe mbylljen e bizneseve. Bizneset nuk do të kenë alternativa dhe do të

kërkohej të futen në procedura të falimentimit", tha Rukiqi.

Kosova deri më tani ka zbatuar Pakon emergjente fiskale në vlerë të rreth 180 milionë eurove. Kjo pako, e cila kishte për qëllim t'i zbuste problemet ekonomike dhe sociale, ishte miratuar në muajin mars, pas konfirmimit të rasteve të para me koronavirus, nga qeveria e udhëhequr nga ish-kryeministri Albin Kurti. Kurse disa nga masat e saj janë duke u zbatuar pas ardhjes së qeverisë së udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti.

Mekanizmat financiarë ndërkombëtarë në raportet e tyre të publikuara për efektet e pandemisë në ekonominë e Kosovës kanë vlerësuar se janë shkaktuar dëme të mëdha. Banka Botërore në raportin e saj ka paraparë një rënie ekonomike prej 4.5 përqindësh në Kosovë në vitin 2020.

## Borxhet e bizneseve ndaj ATK-së gjatë pandemisë mbërrijnë në 53 milionë euro

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Gjatë periudhës janar-gusht Administrata Tatimore e Kosovës ka arritur të realizojë mbi 302 milionë euro të hyra, ka konfirmuar në një intervistë për "Ekonomia Online" drejtori i këtij institucioni, Ilir Murtezaj. Por, si shumë institucione të tjera, edhe ATK-ja gjatë kohës së pandemisë ka hasur në vështirësi, gjë që i ka pamundësuar edhe implementimin e objektivave. "Administrata Tatimore e Kosovës në periudhën janar-gusht 2020 ka arritur të realizojë 302.3 milionë euro, të hyra tatimore si dhe pjesa prej 120.5 milionë eurosh kontribute pensionale. Realisht gjatë kësaj periudhe ATK-ja ka pasur edhe vështirësi të veta në implementim të objektivave të tyre dhe në realizim të qëllimit primar që ka realizimin e të

hyrës tatimore për buxhetin e shtetit, por edhe të të hyrave të tjera të cilat janë në drejtim të luftimit të informalitetit", ka thënë ai.

Ai thotë se ATK-ja prej janarit e deri më 18 mars ka pasur performancë të shkëlqyer, duke arritur ta tejkalojë edhe planin e paraparë në fillim të vitit për 3.62 për qind. "Në periudhën janar-gusht 2020 ne duhet ta ndajmë në dy etapa, në periudhën para pandemisë prej janarit deri më 18 mars, ku gjatë kësaj periudhe ATK-ja ka pasur një performancë të shkëlqyer duke arritur ta tejkalojë planin e paraparë në fillim të vitit për 3.62 për qind si dhe t'i tejkalojë të hyrat e realizuara të periudhës janar-18 mars 2019 për 11.2 për qind. Pas 18 marsit, si rezultat i ndikimit të pandemisë, kemi pasur një trend të rënies të të hyrave tatimore si rezultat i



pandemisë, por edhe të dy vendimeve të Ministrisë së Financave për zgjatje të afatit për deklarimin e pagesës së tatimeve, gjë që kjo ka bërë që në periudhën mars-prill të kemi një rënie të

theksuar të të hyrave tatimore, me një rikthim në periudhën maj-qershor. Prapë periudha korrik-gusht ka një rënie më të lehtë të hyrave tatimore gjatë kësaj periudhe", ka deklaruar Murtezaj.

Pandemia ka ndikuar që në Administratën Tatimore të rritet edhe stoku i borxheve. Murtezaj ka theksuar se kanë pasur rritje të stokut të borxheve prej 53 milionë eurosh.



# A ËSHTË E MUNDUR TË JETË BASHA KRYEMINISTRI I ARDHSHËM I SHQIPËRISË? ÇFARË THONË SONDAZHET (JO ATO PUBLIKE)



**Nga Bedri ISLAMI**

Në secilën ditë të katër viteve të fundit është dëgjuar i njëjti refren nga drejtuesi i opozitës: Unë do të jem kryeministri i ardhshëm, së bashku me premtimet e zhurmshme për të ndryshuar gjithçka.

Është e natyrshme që secili drejtues i opozitës të synojë të jetë shefi i qeverisë së ardhshme. E panatyrshme është që ende pa kaluar lumin, të bërtasësh "hopa". Është e pranueshme që opozita të ketë një figurë qendrore për të qenë shefi i qeverisë së ardhshme, por kur shfaqen më shumë se një dhe kur pazaret politike përfundojnë në ndarje postesh, ende pa ditur asgjë,

kjo është mjerim i politikës. Basha nuk është i vetmi që synon të jetë drejtuesi i qeverisë së ardhshme, në fakt kjo ka qenë ëndrra e tij që kur drejtuesi i vjetër e gjeti atë më të përshtatshmin për të qenë drejtuesi hije, pra që nga momenti kur Berisha e perceptoi Bashën më të dëgjueshëm se sa Olldashin dhe që nga momenti kur për familjen Berisha, roli primar i duhej dhënë njërit prej tyre. Tani edhe Meta po bën sprovat e tij për të qenë shefi i ardhshëm i qeverisë, një zanat që e ka provuar një herë dhe nga i cili, "taksa" 10 për qind për çdo tender u ngrit në 20 për qind.

Riciklimi i emrave për një post të çon drejt një mendimi: a do të jetë vërtet Basha kryeministri i ardhshëm i Shqipërisë? Vështirë, në mos e pamundur. Për më tepër, më shumë e përealizueshme, se sa e mundur. Përballë Bashës është lideri i

sotëm i qeverisë dhe i shumicës së majtë, që, në të gjitha sprovat e bëra, që nga votimet e para, me vetëm një përjashtim, vitin 1992, është forca kryesore politike dhe e qëndrueshme.

Elektorati i saj ka qenë më stabil se të tjerët, më i lidhur me elitën drejtuese, edhe kur ajo e ka mbushur kupën dhe është shkëputur prej saj dhe, megjithëse nganjëherë zemërthyer, përsëri ka qëndruar në bindjen e vet se, zgjedhja e një lideri të së majtës është e keqja më e vogël.

Edhe tani është e njëjta pamje. Sondazhet e ndërmarra nga institucione të besueshme jashtë Shqipërisë kanë bindjen se elektorati i së majtës do të jetë ende në qëndrueshmërinë e tij dhe se, megjithë rritjen që mendohet të jetë në dobi të opozitës, asgjë nuk do të mund të kthejë përmbys gjërat.

Ato që Basha dhe ekipi i tij këshillues izraelit mundohen

të rregullojnë gjatë ditës, fillimisht ia prishin rivalët e shumë të tij gjatë natës. Edhe nëse ai përpiqet, lëvizje e vonuar e tij, për t'u ndarë nga e djeshmja, qoftë edhe përmes figurave si Ruli, ia ndalojnë me vrull dy përballës politikë të regjur me kalkulime, që herë - herë kanë qenë kundërshtarë dhe armiq të njëri tjetrit, e më së shumti i kanë bërë së bashku llogaritë, janë pasuruar bashkërisht, kanë mrizuar në të njëjtën kohë dhe kanë krijuar një oligarki politike, përmes së cilës, dhunshëm, kanë përmbysur të gjithë strukturat e shtetit. Dyshja Meta - Berisha janë kundërshtarët më të fuqishëm përballë Bashës dhe hedhësit poshtë të çdo ndryshimi që ai mund të kërkojë të bëjë, gjithnjë me gjysmë zëri, duke e ditur se shtati i tij si lider shkurtohet vazhdimisht.

26 prilli do të jetë një ditë ndryshe nga të tjerat: nuk do të jetë përmbysëse, por e veçantë.

Ata që humbin do të largohen, ndoshta përgjithnjë nga politika, fituesit, nëse do të ketë rotacion, do të fillojnë betejën brenda llojit për ndarjen e pushtetit, lëvizjet e reja politike presin me ankth nëse do të jetë pjesë e mendimit kuvendar.

Përballjet do të jenë të rënda, klima politike do të jetë më përvëluese se asnjëherë, motorët janë ndezur që tani dhe në secilën ditë do të ketë një mjedis lufte që nuk do të mund të kthehet në përlëshje. Basha, duke synuar të jetë shefi i ardhshëm i qeverisë do të përpiqet t'u prijë opozitarëve dhe të lodhurve nga mosqeverisja në përballje, do të ketë shansin të ndezë klimën dhe të ndjellë gjendjen e përlëshjeve, për të paraqitur luftën.

Ai e ka ndjerë tri herë përballjen me Ramën; e di se tani nuk është në pushtet për të përmbysur votat si në zgjedhjet bashkiake, mentori i



tij Berisha nuk është kryeministër; nuk mund të futë vota në kutitë e hapura, pasi Ristani nuk është më askush në partinë e tij, veçse një numër; nuk mund të ushtrojë dhunë dhe as të nxjerrë nga burgjet disa ditë para votimeve horrat e banditët, pasi nuk është ministër i brendshëm dhe, së fundi, nuk mund të bindë pasuesit e Topallit, Bodes, Imamit, Rulit, Mustafajt, se ai ka ndryshuar dhe se mund t'i besohet përsëri.

Ai mbetet i pabesuari i madh, pasi gjithë besimin që nuk ia heq pushteti, ia largojnë me të njëjtin zell ata që ka kundër në vetë partinë e tij. Nëse ai humbet - do të shkojë në vilat e tij luksoze. Nuk ka rrugë tjetër, por, ai, më mirë se të tjerët, e di, se askush nuk do të mërzhitet nga shkuarja e tij dhe se të shumtë janë ata që e shohin të përkohshëm.

Ndaj i duhet fitorja gjithsesi, por është një fitore që e gëzon opozitën, pasi vjen në pushtet, por jo rivalët e tij që nuk e duan aty ku e kanë vënë dhunshëm shefi i tij politik.

\*\*\*

A do të kemi të bëjmë me një kryeministër të ri, në këtë rast me Lulzim Bashën, kjo është pyetje e shtruar tashmë, e tellallisur aq shumë nga ai vetë dhe disa personazhe gjysmë groteskë pranë tij, e nënvizuar nga Kryemadhi, sapo u hodh teza e rikthimit të

bashkëshortit të saj në zyrën kryeministore, si për të dashur qetësimin e përkohshëm të Bashës, por, nga ana tjetër e shtruar shumë pak herë nga kancelari jashtë shtetit shqiptar.

Ndoshta shenjë mosbesimi apo shenjë njohje e një karriere që befasoi gjithkënd, shpesh herë të dështuar, të lëvizshme dhe të anatemuar nga rivalët e përjashtuar prej tij.

Basha e di mirëfilli se rënia e tij, humbja dhe dëbimi nga PD-ja, do të jetë shkasi tjetër për të bërë anatominë e shkurtër politike të një njeriu që nga e panjohura e madhe, sa mirë kaloi drejt posteve të rëndësishme qeverisëse në të cilat, ndërsa nuk la pas asgjë për të përmendur për të mirë, la pas vetes një humbëturë të gjithanshme, me një dëmtuesë të pazakonshme në jetën ekonomike e financiare të vendit, në jetën politike dhe në vetë shtetin.

Vetë ata që rrinë afër tij sot do të vrapojnë të gjejnë dëmet dhe do ia përmendin të gjitha çfarë kanë bluajtur me vete dhe, sado që bashkë me të do të mënjanohej disa figura të rëndomta politike, disa nga të cilët shkojnë deri në përbuzje, ata që presin me shpatë në dorë do të jenë më të shumtë dhe Basha këtë e di.

Në mos e ka ditur, 2 marsi i këtij viti ia mësoi se e keqja e tij vjen nga presidenca, nga zyrat e ish liderit të tij, nga selitë e partiçkave që i janë qepur dhe që nuk mund të vegjetojnë ndryshe.

Pikërisht këta, më shumë se të tjerët, do ia kujtojnë se ai është i panjohuri i ardhur nga zyrat e të huajve në Kosovë, ku nuk dihej ende se kush e kishte gjetur e që më pas, do të vinte këtu përmes bekimit të një serbo-boshnjaku, Fazliq, nuk mund të paraqiste asnjë kredencial tjetër, veç shtetit të gjatë, pamjes së bukur dhe miqësisë me vajzën e liderit të opozitës që shumë shpejt, sapo të bëhej kryeministër, postin më të begatshëm, do ia besonte atij.

I besuar tri herë, duke përdhosur tri herë postet e tij, përmes vjedhjeve, vrasjeve dhe tradhtisë së kombit, ai të gjitha do i përcillte përmes një buzëqeshje karakteristike të personazheve të Dikensit.

Ata, vajtojat e politikës, do ia kujtojnë se çuditërisht, ky njeri, pa asnjë mendim të tij politik dhe pa asnjë thërrime vizioni, pa asnjë të shkuar, u bë njeriu i së ardhmes në PD-në e dhuruar dhe nga e cila, pasi skicoi fundin politik, (të jetë vetëm kaq!) të Olldashit, fundosi edhe një plejadë, që thënë të drejtën, me ndonjë përjashtim, nuk i janë dhimbshur shumë kujt.

Zgjedhjet e vitit të ardhshëm, që nuk po bëhen si kishte

paralajmëruar, he sot e he nesër, por në kohën e caktuar, janë limiti i fundit dhe pas tyre, as nuk mund të ngrijnë mandatin e kryetarit, për ta shkruar më pas; as nuk mund të rikandidojë, pasi loja ka mbaruar; as nuk mund të viktimizohet se e preu në besë Edi Rama, as nuk do të mund të gëzojë mbrojtjen e Berishës, i cili është i gatshëm ta shesë që nesër.

Njerëzit pranë tij do ia kujtojnë vullshëm se, njeriu i panjohur, kamerieri i dikurshëm i Rinasit, i emëruar apo i dërguar, këtë askush nuk e di, poseduesi i një pasaporte amerikane, për të cilën askurrë nuk e tregoi se si kishte arritur tek ai, i dyshuari i dosjeve të atyre që kishin bërë luftën në Kosovë, ndihmësi i hetuesve apo vetë hetuesi i çështjeve përvëluese të pas luftës, njëri nga ata prej të cilëve do të dilte e plotë dosja e Millosheviqit, edhe me ato që ishin thënë në korridoret e në bisedat e lira; njëri ndër krijuesit e legjendës famëkeqe të Shtëpisë së Verdhe, ku, si duket, nuk kishte qenë vetëm përkthyesi, por edhe kallauzi që sapo kishte dëgjuar se diku aty ishin mjekuar të plagosur nga lufta e kishte përcjellë prapësht lajmin; tani do të ishte figura kryesore e opozitës, që, të paktën në një rast, tregoi se edhe brenda vathës së tij, ajo që shitet kushton më shtrenjtë se vlera që është fluide.

Për të parën herë ai i dërgoi listat e kandidatëve për deputetë të PD si në serialet turke, një pjesë sot e një tjetër nesër...sipas ligjit të kërkesë - ofertës.

Basha po drejton një opozitë që vetëm e reformuar nuk është. Ajo është e deformuar. E ndarë në pjesë, ku secili kërkon të tërheqë jorganin mbi vete. E përbërë në shumicë nga njerëz pa vizion, por të pangopur, ata e dinë se Basha është lideri i dobët që nuk mund të forcohet, edhe po të kishte dashur.

Zgjedhjet janë momenti kur ai do e dijë mirëfilli se fati që i erdhi në duar në vitin 2005 përmes lidhjeve miqësore me bijën kryeministore, po aq lehtësisht, pas 16 viteve, do i rrëshqasë dhe ai do të jetë vërtetë një njeri i pasur, por i dërmuar nga vetë njerëzit rreth tij.

Opozita e tashme, si asnjëherë tjetër është e çartur në mendimin e saj politik; ajo sheh armiq edhe ku mund të jenë miqtë e saj; ajo e përcakton nivelin e saj sipas mendësisë së Ndokës, perceptimit të Dukës, grekomanisë së Dules dhe shitblerjes së lësëisë.

Asgjë e re nuk pritët prej tyre; me to Basha mund të jetë i mirë ose i lig nga vendi që do i vendosë nëse listat janë të mbyllura, ose nga manipulimi

i numërimit, nëse listat janë të hapura. Basha e ka luftën finale, por ende nuk e di se kambanat po bien për fundin e tij politik.

Të drejtosh një opozitë që kudo sheh armiq, që shpall gjithë diplomacinë ndërkombëtare si armike, që sheh tek çdo qëndrim ndërkombëtar njerëz me thika që duan të shkatërrojnë këtë vend, që delegojnë të zezën në vend të së vërtetës, që duket sikur kanë shpallur luftë me gjysmën e botës, është e vështirë, e papërballueshme dhe, në fund të fundit, shenjë rënie.

Asnjëherë tjetër, nga askush, edhe kur liderë si Nano kanë qenë të burgosur apo si Rama, të vjedhur masivisht, nuk kanë bërë kështu kundër vendit të tyre, nuk kanë pasur këtë tërbim, deri në shtazëri ndaj një shteti ku bëjnë pjesë dhe ku rastësisht kanë lindur. Ka disa muaj, por sidomos pas 25 qershorit, kur dështimi ishte aq i turpshëm, që Basha dhe një grup rreth tij, shumica të pavlerë brenda vendit, por të fryrë jashtë tij, po bëjnë të gjitha përpjekjet për të dërguar imazhin e një Shqipërie tjetër, krejt tjetër, e cila, edhe pse është larg asaj që njerëzit duan, nuk është ajo e Bashës. Një sulm aspak befasues ka shpërthyer kundër çdo njeriu, institucioni dhe organizmi që, sado pak, ka interes të mbarë ndaj vendit, që synon të shpejtojë interimin e tij, dhe që, në një formë a në një tjetër, duke harruar se grupimi politik është më i pakët se sa vlera e një shteti, merr përsipër të bëjë diçka në të mbarë.

Basha, si askush tjetër, në çdo qelizë institucionale ku ka pasur mundësi ka nisur kasnecët e tij dhe kjo nuk është bërë e nuk po bëhet falas, se ashtu ia do qejfi atyre që marrin përsipër të nxijnë këtë vend. PAGESA të mëdha, nga të cilat vetëm disa dihen e deri tani janë bërë të njohura, janë nisur drejt këtyre grupimeve për një mision të vetëm, nxirjen e një vendi që e dërrmoi më 25 qershor dhe që, edhe tani, nuk e merr veten nga kjo dërrmë.

Nuk është vetëm etja për pushtet ajo që e shtyn një njeri të politikës, aq më tepër një shef opozite, drejt karriges kryeministore. Në këtë rast, është shumë më tepër se kaq. Beteja për kryeprokurorin ishte vetëm njëra prej tyre; bllokimi i emërimeve në Gjykatën Kushtetuese, një tjetër; përshfaqja e opozitës si një detachment sulmues, po ashtu; shfaqja e oligarkisë financiare që mund të shkërmoqet nuk është e gjitha. Detyrime më të mëdha qëndrojnë pas gjithë këtyre përpjekjeve të pareshtura për të hedhur gjithçka në greminë, për të shfaqur para botës një shtet që, megjithëse ka

dhjetëra probleme të mëdha, shumë nga të cilat të lënë prej atyre që ikën, e të tjera të krijuara prej këtyre që janë në pushtet. Përsëri nuk është ai që përpiqen të shfaqin.

Në takimet e fundit të opozitës me statuta të njohura të politikës së mendimit të djathtë evropian, disa nga të cilat kanë trajtuar ndryshe nga ai shtetin shqiptar, është folur me tërbim të pazakontë, janë sajuar fakte dhe ngjarje sipas "qytetarit digital" dhe është krijuar një tablo sinoptike sipas stilit të hoxhizmit. Pas takimeve të fundit të figurave opozitare në selitë perëndimore ka prej tyre që kanë ngritur çudinë dhe kanë dyshuar nëse këto njerëz mbajnë vërtetë një pasaportë shqiptare.

Është një e vërtetë e pamohueshme: në të gjithë atë që ka bërë në jetën e tij politike, pas humbjes së parë të madhe, në qershorin e vitit 2013 dhe, si nuk ishte menduar, ardhjes së tij në drejtimin e PD-së me bekimin e të parit të fisit të tij politik, Berishës, dërrmimi i vitit 2017, më i turpshmi nga të gjithë humbjet, ka qenë synimi për të ardhur në krye të qeverisë sa më parë të jetë e mundur. Është njëra nga pamundësitë e mëdha dhe për më tepër e ditur.

Që të jemi të saktë deri në fund, të paktën me bindjen tonë, qeveria Rama nuk është ajo që është pritur dhe nuk ka sjellë atë që njerëzit kanë menduar. Ka njerëz të devotshëm ndaj saj që janë të zhgënjyer dhe që do të kishin dashur të ishte në shumëçka ndryshe.

Është lehtësisht e përfytyrueshme në dëshpërimin e zhgënjimin e shumë njerëzve me politikën e mosndëshkimit të së keqes, lejimin e saj e, në jo pak raste, vazhdimin në një formë tjetër. Opozita kërkon të rrëzojë një qeveri që nuk është më e mira e mundshme, por, për fat të keq, është më e pranueshme se sa ajo që mund të paraqesë një opozitë ku gëlojnë figurat e vjetra, të provuara dhe të dështuara.. Opozita dhe vetë Basha e dinë këtë. Ndaj, jo rastësisht, gjithnjë e më shumë po i kthehet retushimit të politikës përmes risjelljes në pushtet të duarve të forta, qendrestare, të njohura për përleshje dhe luftë, si Meta dhe Berisha.

Basha i di të gjitha këto. Por atij i duhet një Shqipëri me imazhin e saj të copëtuar, të lodhur, të stërkequr, në mënyrë që një politikë tjetër, ajo serbe, të mund të ketë duart e lira në Kosovë, të sjellë edhe një herë ëndrrën e saj për Kosovën si një Jerusalem serb. Përse ndodh kjo: Krejt thjeshtë: Haraçet e borxhet e vjetra paguhen një ditë!

**E rrallë**

## Del në shitje skeleti 67 milionë vjeçar

Skeleti i një prej dinozaurëve më të mëdhenj grabitqarë pritet të dalë në shitje në muajin tetor. Shtëpia britanike e ankandeve do ta ekspozojë fillimisht për publikun tiranosaurin. Skeleti i specit gjigante, sipas shkencëtarëve, është përafërsisht 67 milionë vjeçar. Ai është një tiranosaur, i njohur si "STAN", që u zbulua fillimisht më 1987 në Dakotën e Jugut nga paleontologu amator Stan Sacrison.



**FOTO E DITES**



Pamje nga Kalaja e Rozafës në Shqipëri

## BARSOLETA E DITËS



Pasi ishin ulur në një prej tavolinave të restorantit, gruaja sheh nga banaku dhe i thotë partnerit të ri: - E sheh atë burrin atje? Ai është ish-bashkëshorti im. Qëkurse jemi ndarë, këtu e tre vjet më parë, vetëm vazhdon të pijë. - Ua, i përgjigjet partneri, është hera e parë që dëgjoj që një njeri vazhdon të festojë kaq gjatë!



## Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E jashtëzakonshme

## Restoranti që po merr vëmendjen e mijëra vizituesve

Nëse ju doni të pini një filxhan çaj ose të hani një drekë të shijshme do të duhet të merrni parasysh disa gjëra para se të shkoni. Ky restorant në Weissbad ndodhet rreth 5 000 metra mbi nivelin e tokës dhe është i vendosur në anë të një mali në Alpet zvicerane. Për të arritur atje do t'ju duhet të bëni një udhëtim me teleferik për 20 minuta dhe më pas të ecni në një terren të pjerrët. Ky restorant është ndërtuar si një shtëpi për mysafirët në vitin 1884 nga disa fermerë të cilët kishin nevojë për një vend për t'u qetësuar teksa dhitë e tyre kullotnin në barin atje.



**DASHI**

Një lehtësim i vogël do të vijë pas disa ditësh të vështira. Hëna në Akrep, në fakt, ju ofron mundësinë për të ndrequr një gabim.



**DEMI**

Nëse jeni i dashuruar, nëse keni një partner, nuk mund ta duroni më, por rreziku do të jetë t'i përsërisni të njëjtat gabime.



**BINJAKËT**

Përqendrohuni në jetën e përditshme dhe mirëqenien fizike. Mos u lodhni shumë dhe zhytu në qetësinë tuaj.



**GAFORRJA**

Klima sentimentale nxehet dhe mirëkuptimi i dyanshëm gjen hapësira të reja! Ata që kanë një marrëdhënie solide dhe të lumtur do të gjejnë më shumë arsye për të konfirmuar veten në zgjedhjet e tyre.



**LUANI**

Duke fjetur në një jastëk anatomik, do ta shmangni rrezikun që ju kanoset. Shpenzimi nuk është shumë dhe vërtet ia vlen!



**VIRGJËRËSHA**

Ju keni gjëra të shkëlqyera në mendje, por nuk mund t'i arrini ato me shpejtësi siç dëshironi. Armatosuni me një dozë të mirë durimi.



**PESHORJA**

Mendonit me kujdes para se të veproni! Në marrëdhëniet në çift do të jeni në gjendje të krijoni një bashkëpunim të mirë që do t'ju ndihmojë të largoni çdo dyshim.



**AKREPI**

Tema e preferuar e kësaj dite do të jetë koha e lirë dhe dëshira për të shpëtuar nga angazhimet e zakonshme. Organizoni diçka të veçantë me miqtë.



**SHIGJETARI**

Dita ju gjen shumë të qetë ndaj miqve dhe personit që dëshironi ta bëni tuajin ose që tashmë është i juaji.



**BRICJAPI**

Përballemi me qetësi të papritur dhe nëse planifikoni diçka për të dielën, mos e ekzagjeroni.



**UJORI**

Kur bëhet fjalë për lidhjen në çift, ndiheni i zhgënjyer në sjelljen e partnerit tuaj, i lënduar nga diçka që mendonit se e kishit kapërcyer.



**PESHQIT**

Marrëdhëniet shoqërore do t'ju ofrojnë mbështetje, argëtim dhe ide për ta zgjeruar rrethin e të njohurve tuaj.

## Ish-gruaja e Tom Cruise del hapur me të dashurin e ri



**K**atie Holmes nuk e ka aspak problem që të shfaqet në publik me të dashurin e ri, shefin e njohur Emilio Vitolo Jr. Aktorja e famshme u kap mat sërish në momente intime me 33-vjeçarin. 44-vjeçarja e kishte mbërthyer me krahët e saj të dashurin dhe dhanë "shfaqje" teksa putheshin në trotuar. Pasi kaluan

disa ditë romantike së bashku, dyshja tani duket se është e pandashme. Ata fotoqofohen herë pas here jashtë restorantit të familjes së Emilios në Nju-Jork. Ish-bashkëshortja e Tom Cruise dukej mjaft mirë në shoqërinë e të dashurit të ri, ndërsa të dy vështronin njëri-tjetrin me maskat e fytyrës të ulura poshtë.

## Luana Vjollca vjen me poza të 'nxehta' nga fotosesioni për "Guess"



**M**oderatorja e famshme shqiptare, Luana Vjollca, rikthehet me sesionin fotografik për markën e famshme

"Guess". Ajo shfaq format bombastike, me një fustan të zi të shkurtër që vinte në pah fizikun dhe dukej e parezistueshme.



## Irina rikthehet sërish, shfaqet me vajzën dhe fiton vëmendjen e të gjithëve

**T**ë gjithë janë të afeksionuar pas modelueses Irina Shayk për bukurinë marramendëse që ajo ka dhe për profesionin që ushtron, por në dashuri ajo është me të vërtetë e pafat. Fillimisht gjërat mes saj dhe yllit të futbollit Cristiano Ronaldos nuk shkuan mirë, më pas erdhi dhe lamtumira nga aktori Bradley Cooper. Me aktorin modeluesja ka një vajzë të quajtur Lea De Seine, e lindur


në vitin 2017. Tani që bota e modës është disi në një ngërc për shkak të pandemisë, Irina Shayk ka kthyer trotuaret e qytetit në pasarelën e saj. Ajo është fotografuar teksa shëtit të voglën Lea. Ajo u shfaq e veshur me një bluzë të bardhë që i tregonte barkun e sheshtë e të tonifikuar, ndërsa më të hijshme e bënte xhaketa e zezë që mbante veshur.

## Këngëtarja 'thumbon' ish-partnerin për aftësitë në shtrat



**A**jo ka pasur një vit me ulje-ngritje, ndarje dhe duket se do t'i transmetojë disa deklarata në albumin e saj të ardhshëm, shkruan "DailyMail". Miley Cyrus po punon shumë në albumin e saj të shtatë në studio, të titulluar "She Is Miley Cyrus", ku janë disa referenca për martesën e saj të

dështuar me ish-burrin Liam Hemsworth. Këngëtarja e hitit "We Can't Stop", 27-vjeçare, thuhet se thumbon Liam në disa vargje, duke përfshirë "Win Some, Lose Some", në të cilën ajo këndon: 'Nuk mund t'i numëroj të gjitha kohët kur jam shtirur, falë Zotit për mendimet në kokën time'.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Feroniekli deklasoi Gjilanan, fitojnë edhe Prishtina dhe Ballkani

Feronikeli ka treguar “dhembët” në javën e parë kundër një rivali të fortë siç është Gjilani, ndërsa Bedri Greca dhe Mirlind Daku kanë shkëlqyer duke shënuar nga tre gola për skuadrat e tyre



**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 20 SHTATOR** - Nënkampioni i Kosovës në futboll, Gjilani, e ka nisur në mënyrën më të keqe kampionatin 2020/2021 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi të dielën ka pësuar humbje nga Feronikeli me rezultat 4-0. Skuadra e drejtuar nga Afrim Tovërlani ka treguar lojë të mirë gjatë gjithë ndeshjes dhe me meritë të plotë mori pikët maksimale.

Transferimi i ri i “Niklit”, Bedri Greca, shfaqti formë të jashtë zakonshme duke shënuar tre gola në këtë përballje. Ai fillimisht shënoi në minutën e 14-t, kurse golin e dytë e realizoi tre minuta para fundit të pjesës së parë. Golin e tretë e shënoi në minutën e 54-t, kurse golin e fundit në ndeshje e realizoi Santos në minutat shtesë.

Trajneri Afrim Tovërlani është shfaqur i kënaqur pas ndeshjes me lojën dhe rezultatit, kurse ka mbetur i befasuar nga paraqitja jo e mirë e Gjilanit. “Sa i përket angazhimit është për çdo lëndatë. Kemi pasur raste për të shënuar më tepër gola, por gjithsesi kemi mbetur të kënaqur edhe me këtë rezultat, sidomos ndaj një skuadre të fortë si Gjilani që, për t’ju thënë të drejtën, më ka befasuar jo për të mirë. Ne kemi ende për të punuar që të komponohemi sa më shumë në ndeshjet e

radhës”, ka thënë Tovërlani.

Ndërsa trajneri i Gjilanit, Gentjan Mezani, ka thënë se skuadra e tij bëri gabime amatore. Edhe përkundër faktit se Gjilani kishte mungesa të shumta, pranimi i katër golave për trajnerin Mezani është i papranueshëm. “Mendoj se Feronikeli shfrytëzoi mirë gabimet tona. Ai e dëshoi fitoren më shumë. Kjo ishte arsyeja pse e arriti. Ne nuk arritëm të shfaqim atë që mund të shfaqim”, ka thënë Mezani, duke shtuar se: “Kemi bërë gabime amatore si skuadër. Shpresoj t’i përmirësojmë sa më shpejt sepse gabime të tilla nuk falen. Kampionati është i gjatë, por është mirë që gabimet t’i përmirësojmë më shpejt. Kemi pasur mungesa, por s’duhet të shfaqeshemi. Lojtarët që futen në fushë duhet ta japin maksimumin e jo të pësojnë katër gola”.

Të shtunën janë zhvilluar edhe dy ndeshje të tjera në rangun elitare të futbollit, kurse fitoreve u janë gëzuar Prishtina dhe Ballkani në përballje me Drenicën, përkatësisht Besën e Pejës. Fituesja e Kupës, Prishtina, në stadiumin “Fadil Vokrri” e ka mposhtur Drenicën (3-0). Në pjesën e parë Leotrim Bektashi shënoi golin e parë për vendësit, kurse në pjesën e dytë shënuan edhe mesfushori Endrit Krasniqi dhe sulmuesi Otto John. Ndërsa skuadra e Ismet Munishit, Ballkani, e ka mposhtur bindshëm Besën (1-4) në

ndeshjen e parë pas rikthimit në Superligë. Sulmuesi Mirlind Daku ishte i pandalëshëm në këtë ndeshje dhe shënoi tre gola, kurse një tjetër e shtoi Ermal Krasniqi. Golin e nderit për pejanët e shënoi Salihu në fund të ndeshjes. Ndeshja në mes të Dritës dhe Llapit është shtyrë për shkak të pjesëmarrjes së skuadrës gjilanasë në garat e Ligës së Evropës.

## SUPERLIGA - Java 1

Feronikeli - Gjilani	4-0
Prishtina Drenica	3-0
Besa Ballkani	1-4
Trepça '89 Arbëria	0-2
Drita - Llapi (Është shtyre)	

## Tabela

1. Feronikeli	3 pikë
2. Ballkani	3
3. Prishtina	3
4. Arbëria	3
5. Drita	0
6. Llapi	0
7. Trepça '89	0
8. Besa	0
9. Drenica	0
10. Gjilani	0

## SHKURT

### Lajm jo i mirë për Kosovën, lëndohet Kololli

Benjamin Kololli ka shënuar një gol fantastik në ndeshjen në mes të Young Boysit dhe Zurichut, por më pas ai është lënduar dhe në fund të pjesës së parë është zëvendësuar. Klubi zviceran nuk ka dhënë ndonjë detaj shtesë për gjendjen e lojtarit. Ky është një lajm jo i mirë për Kosovën, pasi muajin tjetër do të përballet me Maqedoninë e Veriut në Ligën e Kombeve.

### Hysaj luan në fitoren e Napolit, Rrahmani qëndron bankë

Napoli e mposhti Parmën (0-2) në hapje të edicionit të ri në Serinë A. Te Napoli tërë ndeshjen luajti kapiteni i Shqipërisë, Elseid Hysaj. Ndërkohë Amir Rrahmani, mbrojtësi i Kosovës, qëndroi në stol. Te Parma në stol qëndruan Kastriot Dermaku e Redi Kasa. Dries Mertens dhe Lorenzo Insigne shënuan golat e fitores.

### Muriqi debuton me humbje te Girona

Aro Muriq ka debutuar me fanellën e klubit spanjoll Girona. Muriqi ishte titullar në ndeshjen që Girona e humbi nga Real Zaragoza me rezultat 1-0. Portieri i Kosovës e nisi takimin nga minuta e parë dhe pati një paraqitje mjaft të mirë, por që nuk mjaftoi për ta evituar humbjen në debutim, duke i lënë shije të hidhur. Muriqi ditë më parë kompletoi transferimin e tij në Girona nga Manchester City, në formë të huazimit njëvjeçar.

### Bale: Mourinho më bindi që të rikthehem në Tottenham

Gareth Bale ka folur pas transferimit te Tottenham Hotspur. Shtatë vjet pasi u largua nga klubi, Bale është kthyer përsëri te “Spurs”, por vetëm në formë huazimi. Ylli uellsian ka bërë me dije se ishte trajneri i Tottenhamit, Jose Mourinho, ai që e bindi atë ta linte Realin për të kaluar këtë sezon me Tottenhamin. “Ai (Mourinho) më tregoi për disa pozita ku do të preferonte që të më aktivizonte dhe unë isha i lumtur me to”, ka thënë Bale.

## Mjeku: Schumacheri mund të qëndrojë vetëm ulur

HURTH, 20 SHTATOR - Mjeku neurokirurg Erik Riederer ka zbuluar së fundi gjendjen e legjendës së Formula 1, Michael-Schumacher. Sipas mjekut, ish-piloti 51-vjeçar ndodhet në "gjendje vegeta-

tive" dhe nuk reagon më ndaj familjes së tij. "Schumacheri është në gjendje vegetative, që do të thotë se është zgjuar, por nuk mund të reagojë. Ai merr frymë, zemra i rreh dhe ndoshta

mund të ngrihet për të qëndruar ulur, po jo më shumë", ka thënë ai. "Ky është maksimumi për të. Nuk besoj se ka shanse për ta parë atë siç ishte para aksidentit", ka deklaruar Riederer duke iu

referuar rrëzimit të Schumacherit teksa bënte ski në Alpet Franceze më 2013, ku pësoi goditje në kokë. Aksidenti ishte aq i rëndë sa, edhe pse ai mbante helmetë, ra menjëherë në koma.



## Këndellet Bostoni, fiton në ndeshjen e tretë ndaj Miamit

Orlando, 20 shtator - Pas dy humbjeve radhazi, Boston Celtics zgjohet në ndeshjen e tretë gjysmëfinale ndaj Miami Heatit dhe fiton shifrat 117-106, duke rihapur kështu plotësisht shpresat për një kalim të mundshëm në finalen e NBA-së. Në "AdventHealth Arena" të Orlandos, Celticsi e nisi sfidën me vrull që në fraksionin e parë dhe pas 12 minutave lojë, kishte arritur të vendoste një diferencë prej 9 pikësh, ndërsa ritmin e lartë e ruajti edhe në pjesën e dytë e të tretë. Me 15 pikë diferencë para fraksionit të fundit, Bostoni lëshoi disi, ndërsa Miami u përpoq të reagojë por, pavarësisht fitores në këtë pjesë, nuk arriti ta përmbysë rezultatin e përgjithshëm dhe mori kështu humbjen e parë, raporton "SS".



Bam Adebayo i Miamit ishte sërish në një mbrëmje mjaft të mirë, duke u shpallur më i miri i ndeshjes me 27 pikë të shënuara, 16 rikuperime dhe një asistim, ndërsa për Bostonin shkëlqyen Jaylen Broën dhe Jayson Tatum. Të dy

bashkë arritën të shënojnë 51 pikë, t'i rikuperojnë 121 topa dhe të japin 13 asistime, duke u bërë protagonistët kryesorë të suksesit të parë të Boston Celticsit në gjysmëfinale. Sfidat e radhës mes dy skuadrave do të luhet pas 48 orësh.

## Cuculi: Kundërshtarët e Dritës duhet t'i lënë fjalët dhe t'i shtrëngojnë dhëmbët



GJILAN, 20 SHTATOR - Një ndër futbollistët më të dalluar të Dritës në edicionin e kaluar, Arrian Cuculi, shprehet i lumtur me suksesin që e ka arritur me ekipin gjilanas në Evropë, teksa thotë se kundërshtarët e tyre në Kosovë duhet t'i lënë fjalët dhe t'i shtrëngojnë dhëmbët. Mbrojtësi i Dritës, Arrian

Cuculi, thotë se gjilanasit me paraqitjet në Evropë i kanë bindur të gjithë në Kosovë se e kanë merituar titullin kamion. "Me këtë që e dëshmuam në Evropë, kundërshtarët tanë në Kosovë duhet t'i ndalin zërat, t'i shtrëngojnë dhëmbët dhe të mundohen të na mposhtin. Aktualisht ne jemi ekipi për t'u mundur", ka deklaruar Cuculi

në "Super Sport". "Sileksin e njihim shumë mirë si ekip, si organizim, në përgjithësi si klub. Ne kemi bërë diçka të madhe dhe historike për futbollin e Kosovës. Ky është viti i katërt që futbollit i Kosovës luan në Evropë. Shpresojmë që me këta hapa të vazhdojnë edhe klubet e tjera", ka shtuar Cuculi.

### SHKURT

#### Vinalesi triumfon në garën e Emilia Romagna

Gara e Grand Prix të Emilia Romagna ka qenë gati më interesante e këtij sezoni. E përcjell edhe me disa aksidente, gara e Emilia Romagna i ka takuar pilotit spanjoll të Yamahas, Maverick Vinales. Pozita e dytë i ka takuar Joan Mir të Suzukit, i cili prapa tij la pilotin tjetër të Yamahas, Fabio Quartararo. Pol Espargaro ishte deri vonë në garë në pozitën e dytë, por në fund lëshoi gjithçka nga duart. Në këtë garë në xhiron e dytë u aksidentua ikona Valentino Rossi. Rikthimi i Joan Mir ishte spektakolar për pozitën e dytë, pasi vinte nga pozita e 11-të. Ai tashmë është vetëm katër pikë larg kreut të tabelës kampionale.

#### Juve interesohet për Carrascon

Juventus ka shprehur interesim për të nënshkruar me yllin e Atletico Madridit, Yannick Carrasco, raporton "Calcio Mercato". "Bianconerët" kanë kontaktuar me gjigantët spanjollë mbi një marrëveshje me reprezentuesin nga Belgjika i cili u rikthye në "Wanda Metropolitan" këtë verë. Carrasco ka luajtur për Atletico Madridin ndërmjet vitet 2015-2018 dhe më pas ishte huazuar në disa klube të tjera.

#### Gjashtë 6 futbollistë humbin jetën në Ganë

Bota e futbollit është tronditur së fundmi nga një lajm i ardhur nga Gana. Skuadra e të rinjve të Ganës ishte duke udhëtuar së bashku në një autobus, i cili ka pësuar aksident. Autobusi pas aksidentit të pësuar ka rënë në një lumë, nga ku kanë ndërruar jetë 6 lojtarë të rinj dhe rreth 30 të tjerë janë të plagosur rëndë. Lajmi është konfirmuar nga Federata e Ganës, ku bëhet i ditur aksidenti dhe 6 lojtarë të rinj që kanë ndërruar jetë. Një lajm i trishtë ky për të gjithë botën e sportit, pasi janë ndarë nga jeta gjashtë lojtarë të rinj, me bilancin që rrezikon të rritet, pasi edhe të plagosurit kanë marrë dëmtime të shumta.

#### Underi huazohet në Leicester

Futbollisti i Romës, Cengiz Under, është huazuar për një edicion të skuadra angleze Leicester City. Futbollisti turk është huazuar për 3 milionë euro, ndërsa Leicesteri ka të drejtë ta blejë për 23 milionë euro në fund të edicionit. "E dua Romën, jo vetëm klubin, por edhe qytetin, kulturën dhe njerëzit e këtij qyteti të mrekullueshëm. U jam mirënjohës të gjithë tifozëve për mbështetjen dhe dashurinë që më kanë dhënë që prej momentit tim të parë", ka shkruar Under në "Instagram".

#### Rummenigge: Duam ta mbajmë Alaban

Presidenti i nderit i Bayern Munchenit, Karl-Heinz Rummenigge, foli sërish në lidhje me të ardhmen e David Alabas. Mbrojtësi i krahu të merrzimit shumë me deklaratat e zyrtarit të lartë në lidhje me të ardhmen e tij. "Deklarata u dha, por unë nuk jam një tifoz që të bëj negociata deklaratash në publik. Ne duam të mbajmë Alaban përtej 2021. Ai është me ne prej 12 vjetësh dhe është kthyer në futbollist të jashtëzakonshëm. Shpresoj të gjejmë një zgjidhje. Të dyja palët duam që të gjejmë një zgjidhje. Shpresoj ta arrijmë kompromision, sepse Zahavi është dhe agent i Lewandowskit dhe sezonin e kaluar arritëm marrëveshjen. Shpresoj ta bëjmë të njëjtën gjë edhe me Alabën. Po punojmë për diçka të tillë", ka thënë Rummenigge.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
REGIONAL WASTE COMPANY  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588  
+381(0)390/324 034  
www.cabrati.com  
e-mail. info@cabrati.com  
Gjakovë - Gjakova

**K.R.M. "ÇABRATI"**

Në bazë të nenit 21 të Ligjit numër 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 15.06.2008), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-111 (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 30.05.2012), nenit 21 paragrafi 21.3.6 të Statutit të KRM "Çabrati" Sh.A., Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 16.09.2020, vendosi që me datë 21.09.2020 të shpallë këtë:

## KONKURS

**Pozita:** Kryeshef Ekzekutiv  
**I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve  
**Vendi:** Gjakovë

### Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimin të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë së paku 5 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulentë në biznes, industri ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku 5 vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtarë i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlihet ngushte me veprimtarinë afariste të NP-së;
- të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- të mos jetë i dënuar ose nën hetim;
- një program zhvillimor për kompaninë.

### Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Ne pajtim me Ligjin, Kodin e Etikës, Qeverisjen Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe Statutin, duke iu nënshtruar vetëm përkufizimeve të BD ka autoritetin të lidhë kontrata për Kompaninë;
- Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e Kompanisë të cilat nuk janë në përgjegjësi të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm do të vendosen sipas direktivave dhe përgjegjësisë së Kryeshefit Ekzekutiv;
- Këshillon dhe asiston Bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë së kompanisë si dhe planet e saja strategjike afatgjate;
- I ofron Bordit të Drejtorëve kurdo që është e nevojshme dhe së paku një herë në tre muaj raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga kompania dhe për vendimet kryesore të ndërmarrja nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të kompanisë;
- Ofron Bordit të Drejtorëve rregullisht së paku çdo tre muaj raportet e matjes së performancës së kompanisë;
- Themelon dhe rishikon strukturën organizative të kompanisë, si dhe të fuqisë së ndërlihet në mes të udhëheqësve dhe të punësuarve në kompani;
- I ofron Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet;
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme.

**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

### Procedura e aplikimit:

Aplikacionit duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia);
- Letërnjoftimi - kopje;
- Letër motivimi;
- Deklarata nën betim;
- Diplomën e kualifikimit (minimum universitare) – kopje;
- Dëshminë se nuk jeni nën hetim, jo më të vjetër se 6 muaj – origjinale;
- Programi zhvillimor për kompaninë;

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitën: Kryeshef Ekzekutiv i KRM "Çabrati" Sh.A. Afati i dorëzimit është nga data 21.09.2020 deri me datë 20.10.2020 në ora 16:00.

Kërkesat e dorëzuara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen nga Bordi i Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
REGIONAL WASTE COMPANY  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588  
+381(0)390/324 034  
www.cabrati.com  
e-mail. info@cabrati.com  
Gjakovë - Gjakova

**K.R.M. "ÇABRATI"**

Na osnovu člana 21. Zakona br 03 / L-087 o Javnim Preduzećima (objavljen u Službenom Glasniku od 15.06.2008), izmenjen i dopunjen Zakonom 04 / L-111 (objavljena u Službenom Glasniku od 30/05 .2012), člana 21, stav 21.3.6 Statuta RKO "Čabrati" AD, Upravni Odbor na sednici održanoj dana 16.09.2020, je odlučio da 21.09.2020 objavljuje ovaj:

## KONKURS

**Pozicija:** Glavni izvršni direktor  
**Odgovara:** Upravnom Odboru  
**Mesto:** Đakovica

### Uslovi i potrebne kvalifikacije:

Upravni Odbor želi da se osigura da svi potencijalni kandidati su osobe sa priznatim integritetom koji ispunjavaju uslove kvalifikacije prema članu 17.1, kao i da zadovoljavaju kriterijume o nezavisnosti prema članu 17.2 tačke (d), (f), (j) (k) i (l) Člana 17.3 tačka (a) i (b) obaveze izjave pod zakletvom prema članu 17.5 Zakona o Javnim Preduzećima i da imaju odgovarajuću stručnu spremu i obrazovanje za poziciju koja je u pitanju.

Pored ovih opštih uslova kandidati moraju ispunjavati i ove sledeće posebne uslove:

- Da ima najmanje 5 godina radnog iskustva na visokom nivou menadžmenta u oblasti poslovnog menadžmenta, korporativnih finansija, finansija, upravljanje trezora, banke, konsultantske usluge u poslovanju, industriji ili bilo koje druge oblasti nauke koji se bavi aktivnošću PJ- u trajanju od najmanje pet godina, da je bio javni računovođa, kvalifikovani pravnik ili kvalifikovani pripadnik bilo koje druge profesije koja je usko povezana sa poslovnim aktivnostima PJ;
- da ima visok moralni i profesionalni integritet;
- da ima dokazanu sposobnost za upravljanje;
- poznavanje stranih jezika je prednost;
- da nije osuđivan, ili pod istragom;
- jedan program razvoja za kompaniju.

### Glavne obaveze i odgovornosti:

- U skladu sa Zakonom, Etičkog kodeksa, Korporativnog upravljanja, Javnih Preduzeća i Statuta, podležući samo definicijama UO ima ovlašćenje da sklapa ugovore za preduzeća;
- Sva pitanja u vezi sa poslovanjem Kompanije koje nisu u nadležnosti Skupštine Akcionara, Upravnog Odbora, Komisije za Reviziju ili službenika za Internu Reviziju će biti stavljeni pod direktivama i odgovornosti glavnog izvršnog službenika ;
- Savetuje i pomaže Upravni Odbor u određivanju strategije kompanije i njenih dugoročnih strateških planova;
- Pruža Upravnom Odboru po potrebi, a najmanje jednom u tri meseca izveštaj o velikim transakcijama od strane kompanije i glavne odluke donete od strane rukovodstva u vezi sa vođenjem poslovanja i kompanije radova ;
- Pruža Upravnom Odboru redovno barem svakih tri meseca izvještaj za merenje performansi kompanije;
- Uspostavlja i pregleduje organizacionu strukturu kompanije, kao i interkonekciji moći između lidera i zaposlenih u kompaniji;
- Pruža Komisiji za reviziju sve informacije i pomoć koja može biti potrebna;
- Učestvuje u svim opštim sastancima.

**Plata:** U skladu sa politikom odobrene naknade od strane Upravnog odbora.

### Procedura apliciranja:

Aplikaciji moraju biti priložena i ova dokumenta:

- CV- (Biografija);
- Lična karta - kopija;
- Motivaciono pismo;
- Izjava pod zakletvom;
- Diplomu kvalifikacije (minimum univerzitetsku) – kopiju;
- Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od 6 meseca-original;
- Program razvoja za kompaniju;

Podnošenje prijave i relevantne dokumentacije vrši se kod Sekretarijata Kompanije Društva u zatvorenoj koverti sa naznakom: "Za poziciju: Izvršni Direktor RKO "Čabrati" A.D. Krajnji rok za podnošenje je datum od 21.09.2020 do 20.10.2020 u 16:00 sati.

Zahtevi koji pristižu nakon zadnjeg datuma i nepotpuni zahtevi neće biti prihvaćeni od strane Upravnog Odbora. Formalni intervju i procene će se vršiti nakon isteka roka za prijavu, dok PJ zadržava pravo formiranja kratke liste sa kandidatima koji apliciraju.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT**

**SWISS**

**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

► Eulona Hasani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. Njëmbëdhjetë dhe dymbëdhjetë të shkollës "Ahmet Gashi" Prishtinë.

► "Deholz Industry" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811350446.

► "Beksal Global" SH.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810181842.

► Erdon Koqinaj nga Prizreni, shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Arkitekturës të UP-së, të lëshuar në vitin 2012.

► Jap banesë me qira afër 60 m<sup>2</sup>, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m<sup>2</sup>, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m<sup>2</sup> dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m<sup>2</sup>, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata

më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m<sup>2</sup>. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m<sup>2</sup>, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

